REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik

KAÇANIKU

01Nr.030/03-4623/26
Kaçanik, 05.03.2026

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK

Në datën ***05/03/2026***, në katin e tretë të objektit të Komunës së Kaçanikut, në Sallën e Kuvendit, u mbajt dëgjim publik me temë: "Rehabilitimi dhe ridizajnimi i pjesës së rrugës së Çarshisë së qytetit dhe rrugës përreth Xhamisë së qytetit". Dëgjimi publik u organizua nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Dëgjimi publik nisi në orën 14:00.
Prej strukturave ekzekutive të komunës, në dëgjim publik morën pjesë: Kryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Nënkryetari i Komunës-Xhelal Dema, drejtorët e drejtorive komunale: Korab Krasniqi-DUKMM, Arian Teneqja-DSHPE, Gazmend Bunjaku-DA, Valdrin Dogani-DBF, Suhad Dullovi-DBPZHR, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika Selmani-DSHMS, Arlinda Rakoci Raka-DZHET.

Mbledhjen e kryesoi, Korab Krasniqi – Drejtor në DUKMM

Kryetari i Komunës: Qëllimi i këtij diskutimi është prezantimi i investimit për rehabilitimin dhe ridizajnimin e pjesës së rrugës së Çarshisë së qytetit dhe zonës përreth rrugës së Xhamisë së qytetit. Aktualisht ndodhemi në fazën e hartimit të projektit, mirëpo për hir të transparencës ndaj qytetarëve dhe me qëllim që edhe ju të jeni pjesë e procesit të vendimmarrjes për projekte të rëndësishme për Komunën e Kaçanikut, kemi vlerësuar të arsyeshme organizimin e këtij diskutimi publik. Përmes këtij takimi synojmë të dëgjojmë opinionet, sugjerimet, si dhe vërejtjet tuaja lidhur me këtë projekt, në mënyrë që ato të merren parasysh gjatë procesit të finalizimit të tij.

z.Korab Krasniqi: Jemi takuar sot pikërisht për të diskutuar rreth projektit për rikonstruktimin e rrugës së Çarshisë së qytetit dhe rrugës përreth Xhamisë së qytetit. Siç e dini, për shkak të mbylljes së magjistrales dhe kalimit të mjeteve të rënda nëpër rrugën e Çarshisë, kjo rrugë është dëmtuar në masë të konsiderueshme dhe si rezultat është paraqitur nevoja për ndërhyrje dhe rikonstruktim.
Kur kemi filluar të merremi me këtë projekt, fillimisht i jemi kthyer gjendjes së fundit kur është bërë rikonstruktimi i kësaj rruge, përkatësisht në vitin 2019. Në atë kohë, siç e dini, rruga përreth Xhamisë është shtruar me asfalt. Prandaj, gjatë hartimit të projektit jemi bazuar në atë plan bazë dhe kemi konsideruar se pjesa përreth Xhamisë është një zonë më e ndjeshme, për shkak të formës rrethore dhe fërkimit më të madh të automjeteve në atë segment. Pikërisht në atë pjesë kemi pasur gjithmonë dëmtimet më të mëdha.

Për të mos u kthyer përsëri në të njëjtën situatë në të ardhmen, kemi propozuar që ajo pjesë të rikthehet me asfalt, ndërsa kalldrëmi të hiqet nga ai segment dhe të shtrihet në pjesën tjetër të rrugës së Çarshisë. Siç e dini, aktualisht kalldrëmi është i shtruar deri te parkingu, respektivisht deri te busti i Idriz Seferit. Sipas zgjidhjes së propozuar, kjo pjesë me kalldrëm do të zgjatet dhe do të vazhdojë deri në fund të ndërtesave.
Gjithashtu, në projekt është paraparë edhe zgjerimi i pjesës hyrëse të rrugës te Xhamia, duke marrë një pjesë të trotuarit të Bulevardit Ismail Raka, në mënyrë që qasja të jetë më e lehtë dhe më funksionale. Besoj se shumë prej jush e keni vërejtur se kur kyçeni nga pjesa e sipërme e Xhamisë drejt urës, drejtimi i rrugës ju orienton më shumë për të hyrë sesa për të dalë. Për këtë arsye kemi paraparë zgjerimin e atij segmenti të trotuarit, në mënyrë që qarkullimi të jetë më i qartë dhe më i sigurt për ata që zbresin nga lart dhe vazhdojnë drejt urës.

Në projekt, siç mund ta shihni edhe në paraqitjen grafike:

- pjesa me **ngjyrë të kaltër të hapur** paraqet segmentet që do të shtrohen me kalldrëm;
- pjesa me **ngjyrë të kaltër të mbyllur** paraqet trotuaret që do të trajtohen nga fillimi dhe do të ndërtohen si trotuare të reja;
- ndërsa pjesa me **ngjyrë të gjelbër** paraqet trotuaret ekzistuese që nuk do të preken, përkatësisht segmentin e parkingut poshtë bustit të Idriz Seferit, para lokaleve të Çarshisë dhe para objektit të Komunës. Kjo sepse pjesa para Komunës pritet të trajtohet nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore.

Pjesa më e diskutueshme në projekt është segmenti i paraqitur me **ngjyrë të verdhë**, që është paraparë të shtrohet me asfalt. Siç e përmenda edhe më herët, kemi vendosur që zonat më të ndjeshme dhe ato ku kemi pasur më shpesh probleme dhe dëmtime të rikthehen në gjendjen e mëparshme, pra me asfalt.
Gjithashtu, në këtë projekt një rëndësi të veçantë do t'i kushtohet edhe ndriçimit të Çarshisë. Është paraparë vendosja e një ndriçimi më të ulët dhe më estetik, i cili do të përshtatet me pamjen dhe karakterin e Çarshisë.
Nga ky moment, nëse drejtori i Shërbimeve Publike ka ndonjë shtesë apo sqarim për të dhënë, mund t'ia japim fjalën atij. Më pas do ta hapim debatin me të gjithë ju, për të dëgjuar mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja, sepse në fund të fundit këtë rrugë do ta shfrytëzojmë të gjithë bashkë dhe qëllimi ynë është të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme.
Ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen dhe për kontributin tuaj në këtë diskutim. Besoj se së bashku do të arrijmë në një zgjidhje sa më të mirë për qytetin tonë.

z.Arian Teneqja: Arsyeja pse po bëhet ridizajnimi i kësaj rruge lidhet me nivelin e lartë të dëmtimeve që ka pësuar ajo, kryesisht si rezultat i punimeve në hekurudhë. Siç e dini, për një periudhë pothuajse njëvjeçare kjo rrugë ka shërbyer si rrugë alternative, përkatësisht si magjistrale, për shkak se rruga magjistrale ka qenë e bllokuar nga punimet në tunel.
Për këtë arsye është parë e nevojshme të bëhet ridizajnimi i saj. Pjesa e Çarshisë, e cila edhe më herët ka qenë e shtruar me kalldrëm, do të mbetet përsëri me kalldrëm. Në këtë segment do të punohet më në detaje, duke i kushtuar rëndësi të veçantë infrastrukturës nëntokësore dhe strukturës mbajtëse, në mënyrë që në të ardhmen të shmangen problemet dhe dëmtimet e shpeshta.

Ndërsa pjesa rreth Xhamisë, e cila më herët ka qenë e shtruar me asfalt, do të rikthehet përsëri në asfalt. Kjo për shkak se ajo pjesë lidhet drejtpërdrejt me rrugën kryesore, konkretisht me rrugën Qamil Ilazi, dhe është një segment me frekuentim të lartë të qarkullimit, ku vazhdimisht kanë qasje edhe mjetet e rënda.
Gjithashtu, në projekt është paraparë edhe një zgjerim në pjesën poshtë te kryqëzimi i rrugës Ismail Raka, në mënyrë që ky kryqëzim të jetë më funksional dhe të shmangen vështirësitë në qarkullimin e automjeteve.
Aktualisht kjo rrugë ndodhet në fazën e hartimit të projektit kryesor dhe është planifikuar që gjatë këtij viti të fillojnë punimet për ndërtimin dhe realizimin e saj.

z.Mustaf Koxha: Unë kam një vërejtje lidhur me projektin tuaj. Mendoj se vendosja e asfaltit përreth Xhamisë nuk e arsyeton këtë projekt, sepse duke marrë parasysh se Xhamia është monument kulture, asfalti nuk përputhet me ambientin dhe nuk i përshtatet pamjes së saj. Sipas mendimit tim, do të ishte më e përshtatshme që ajo pjesë të mbetet me kalldrëm.

z.Korab Krasniqi: Nëse ka nevojë për sqarim edhe një herë: pjesa e shënuar me ngjyrë të verdhë është segmenti që është planifikuar të shtrohet me asfalt. Kjo pjesë ka qenë me asfalt deri në vitin 2019. Gjatë rikonstruktimit që është bërë në vitin 2019, ajo është shtruar me kalldrëm. Megjithatë, gjatë këtyre viteve kemi vërejtur problemet që janë paraqitur në atë segment. Për këtë arsye po shqyrtohet mundësia që ajo pjesë të rikthehet në asfalt, në mënyrë që të përballojë më mirë qarkullimin, sidomos duke pasur parasysh edhe qasjen e mjeteve të rënda nga rruga Qamil Ilazi dhe rrugët tjera përreth.

z.Sadik Matluma: Unë mendoj se do të ishte më mirë që të hiqet i gjithë kalldrëmi dhe rruga të shtrohet komplet me asfalt. Kapërcimi me karroca të fëmijëve është mjaft problematik dhe rruga aktualisht është shumë e dëmtuar. Edhe nëse punohet në mënyrë profesionale, mendoj se prapë mund të paraqiten probleme. Prandaj, sipas mendimit tim, do të ishte më mirë që kalldrëmi të hiqet tërësisht dhe rruga të shtrohet plotësisht me asfalt.

z.Korab Krasniqi: Unë personalisht do të isha plotësisht dakord për ruajtjen e kalldrëmit nëse do të kishim të bënim me një traditë 40 apo 50 vjeçare. Mirëpo, një traditë prej vetëm 5 apo 6 vitesh nuk besoj se ka mundur të krijojë aq shumë nostalgji apo vlerë që të konsiderohet domosdoshmërisht për t'u ruajtur si pjesë e trashëgimisë kulturore.
Duhet theksuar se ky kalldrëm nuk ka qenë historikisht në atë vend, por është vendosur më vonë, pasi është marrë nga fabrika. Megjithatë, nuk është se po largohet plotësisht përkundrazi, ai po zgjatet dhe po vazhdohet në pjesën e Çarshisë.
Njëkohësisht, kemi dhënë prioritet edhe rregullimit të fasadave të ndërtesave përreth, me qëllim që t'i japim Çarshisë pamjen që i takon dhe një identitet më të qartë urban e estetik.
Sa i përket pjesës pranë Komunës, ajo ka qenë gjithmonë një zonë më e modernizuar dhe nuk besoj se është e lidhur drejtpërdrejt me kalldrëmin në atë mënyrë që të krijojë një ndjenjë nostalgjie që do ta bënte të domosdoshme ruajtjen e tij aty.
Prandaj, mendoj se sot kemi ardhur në një zgjidhje të arsyeshme dhe taktike, duke balancuar funksionalitetin me ruajtjen e trashëgimisë. Në pjesën që historikisht ka qenë gjithmonë me kalldrëm duhet të ketë zero tolerancë për ndryshim dhe ai duhet të vazhdojë të ruhet. Ndërsa në pjesën që deri në vitin 2019 ka qenë me asfalt, besoj se së paku ekziston hapësirë për debat dhe për një zgjidhje më funksionale.

z.Remzi Reka: Edhe ne si organizata "Gjethi" jemi konsultuar rreth këtij projekti. Sipas vlerësimit tonë, pjesa rreth Xhamisë duhet të ruhet me kalldrëm, pasi në atë zonë ka objekte historike dhe duhet të ruhet karakteri historik i saj. Mendoj se segmenti rreth Xhamisë dhe deri në fund të Çarshisë duhet të jetë me kalldrëm. Megjithatë, ajo që është më e rëndësishme është që gjatë dhënies së tenderit të zgjidhet një kompani që e kryen punën në mënyrë profesionale. Nuk duhet të jetë kriter vetëm çmimi më i ulët, por cilësia e punës, në mënyrë që të mos përsëriten problemet që kanë ndodhur më herët.

znj.Ardita Rrahmani: Komuna e Kaçanikut ka identitetin e saj të veçantë. Ky identitet lidhet ngushtë me Kalaja e Kaçanikut dhe me Xhamia e Kaçanikut, monumente të rëndësishme që datojnë nga shekulli XVI dhe që historikisht lidhen mes vete përmes rrugëve me kalldrëm.
E kuptoj plotësisht tendencën për të parë drejt së ardhmes dhe drejt modernizimit, dhe personalisht jam pro zhvillimit dhe modernizimit të qytetit. Megjithatë, për të ruajtur identitetin e Kaçanikut nuk kërkohet një hapësirë e madhe; kërkohet vetëm vullnet për ta mbrojtur atë pjesë të trashëgimisë që e kemi.
Prandaj, unë jam pro ruajtjes së kalldrëmit dhe ruajtjes së identitetit të qytetit, sepse në të kundërtën rrezikojmë të humbasim një pjesë të rëndësishme të historisë sonë.
Megjithatë, duhet të insistojmë që këtë herë punimet të realizohen në një nivel profesional dhe cilësor, ndryshe nga disa ndërhyrje të mëhershme. E dimë që kalimi i automjeteve me peshë të rëndë ka ndikuar në dëmtimin e kësaj rruge. Për këtë arsye, duhet të merren masa konkrete: ose të ndalohet qarkullimi i automjeteve të rënda në këtë pjesë, ose të gjendet një zgjidhje tjetër e qëndrueshme.
Nuk është e arsyeshme që çdo 4–5 vite të shpenzohen rreth 300,000 deri në 400,000 euro për riparimin e kalldrëmit.

z.Korab Krasniqi: Sa i përket çështjes së identitetit, dua të theksoj se ajo pjesë do të ruhet. Megjithatë, pjesa që është realizuar në vitin 2019 mendoj se është një periudhë shumë e shkurtër për ta lidhur drejtpërdrejt me identitetin e qytetit. Pika e vetme më e ndjeshme është segmenti rreth Xhamisë, i cili ka qenë me asfalt deri në vitin 2019. Ndërsa për pjesën tjetër nuk ka diskutim që do të vazhdojë të mbetet me kalldrëm.

z.Qendrim Vogliqi: Para se të filloj të jap sugjerime rreth propozimeve në këtë projekt, dua të shtoj një ankesë lidhur me Drejtorinë e Urbanizmit. Para disa ditësh u kam dërguar një email, ku kam kërkuar që ky propozim të bëhet publik ose të ma dërgojnë në email, sepse ne e dimë që ka qenë i gatshëm. Por, me sa duket, në Drejtorinë e Urbanizmit është bërë si një lloj tradite që të mos kthehen përgjigje asnjëherë.
Para se të bëhet ky propozim, do të kishte qenë mirë të përgatitej një dokumentacion dhe të bëhej një analizë më e thellë. Duhet të shikohet edhe historia dhe të analizohet nëse kemi histori edhe para vitit 2019, e jo të ndalemi vetëm te ky vit. Qytetet, pasi filluan të zhvillohen pas Epokës së Gurit, pra kur njerëzit dolën nga shpellat dhe filluan të jetonin në vendbanime të përhershme, zakonisht ndërtoheshin pranë lumenjve. Edhe Kaçaniku ka një zhvillim të ngjashëm. Për shembull, kalaja është ndërtuar pranë lumenjve sepse jeta ka qenë më e lehtë. Më pas është ndërtuar xhamia dhe shumë objekte të tjera. Nëse kthehemi rreth 500 vite prapa, shohim se zhvillimi i qytetit është bërë rreth xhamisë. Zona më e vjetër për momentin është kjo rrugë që sillet rreth xhamisë. Edhe para vitit 2019, nëse shikojmë më herët, para Luftës së Parë Botërore ose Luftës së Dytë Botërore,

kjo rrugë ka qenë me kalldrëm. Duhet të shikohen fotografitë e vjetra që të mos ndalemi vetëm te viti 2019.
Nëse i shikojmë edhe themelet që kanë dalë këtu para oborrit të komunës, pas formimit të Mbretërisë Serbo-Kroate dhe më pas gjatë kohës së Serbisë socialiste, ata kanë pasur një qëllim të caktuar. Përmes ndërtimeve të reja kanë tentuar të zhdukin një pjesë të historisë. Kjo është bërë duke rrënuar objektet ekzistuese dhe duke ndërtuar objekte të reja që ne sot i quajmë moderne. Në arkitekturë ato njihen si objekte kolektive. Këto objekte shihen përgjatë rrugës Idriz Seferi, duke vazhduar te komuna dhe më pas te stacioni i zjarrfikësve. Besoj se edhe këtu kanë ekzistuar themele të vjetra. Pra, nëse studiohet më gjerësisht, kjo zonë është një zonë shumë e vjetër.
Ajo që unë dua të theksoj është se duhet të identifikohen vlerat historike para se të hyjmë në projektim dhe të merren parasysh arsyet pse duhet të bëhet një ndërhyrje e tillë, si dhe çfarë ka ekzistuar para vitit 2019.
Pastaj duhet të analizohet edhe qarkullimi i automjeteve në këtë zonë. Duhet të angazhohet një inxhinier i komunikacionit që të na japë sqarime dhe versionet më të mira: a duhet të jetë rruga njëkahëshe apo dykahëshe dhe si duhet të organizohet qarkullimi.
Nëse arsyetohet se një pjesë e rrugës prishet dhe tjetra jo, unë mendoj se rruga më e frekuentuar është rruga Idriz Seferi, për të cilën po propozohet të bëhet e tëra me kalldrëm deri poshtë. Aty ka potencial që qyteti të zhvillohet më shumë, sidomos në zonën e objekteve kolektive P+4. Në rast se kemi problem me magjistralen, kjo rrugë mund të shërbejë si rrugë alternative.
Një tjetër element shumë i rëndësishëm është infrastruktura nëntokësore. Para se të bëhen këto ndërhyrje duhet të rregullohen mirë rrjeti elektrik, kanalizimi dhe ujësjellësi, në mënyrë që pas 3–4 viteve të mos kemi nevojë të ndërhyjmë përsëri dhe të prishim rrugën.
Gjithashtu, do të propozoja që të merren si referencë praktikat e mira nga qytete të tjera. Edhe ata që nuk janë profesionistë, planifikues apo arkitektë, por që kanë udhëtuar, kanë pasur mundësi të shohin shembuj të mirë. Për shembull, mund të merren modele nga Gjirokastra, në Bosnje Mostari dhe Prizreni, veçanërisht mënyra se si është trajtuar zona rreth xhamive dhe qendrat historike.
Ajo që dua të theksoj është se kalldrëmi duhet të ruhet dhe duhet të ruhet me shumë fanatizëm, sepse nuk kemi shumë elemente të tjera historike përveç këtyre objekteve. Madje edhe këto objekte, në një mandat të kaluar, janë lyer dhe në një farë mënyre u është humbur një pjesë e historisë.
Prandaj, nëse duam të mos humbim më shumë nga historia jonë, duhet të ruajmë këtë kalldrëm, të paktën nga ura e duke vazhduar deri më poshtë. Edhe nëse nuk vazhdon deri në fund dhe ndalet në gjysmë, kjo nuk ka aq shumë rëndësi. Më e rëndësishmja është që kjo pjesë të ruhet, sepse është bërthama dhe zemra e qytetit, zona më e vjetër rreth xhamisë.

z.Korab Krasniqi: Sa i përket publikimit në ueb-faqen e Komunës, dokumenti për këtë rrugë është publikuar në të njëjtën ditë me njoftimin për diskutimin publik dhe të gjithë kanë pasur qasje të barabartë. Nuk ka pasur dallime në publikim dhe secili ka mundur ta shohë në ueb-faqen e Komunës. Besoj që edhe ju keni pasur qasje dhe nuk mendoj se kemi mbetur borxh në aspektin e transparencës. Sa i përket projektit të detajuar, ai ende është në fazë të projektimit, sepse gjatë procesit kemi kërkuar disa ndryshime. Edhe pas këtij diskutimi publik, besoj se sugjerimet dhe idetë tuaja do të inkorporohen në projekt.

z.Qendrim Vogliqi: Është e vërtetë që njoftimi është bërë, mirëpo linku nuk ka qenë i qasshëm. Nuk e di nëse ka qenë problem teknik apo i IT-së, por kur kemi provuar ta hapim, nuk ka funksionuar. Edhe tani, në momentin që po flasim, linku nuk është i qasshëm. Gjithashtu dua të theksoj një çështje tjetër: kjo është bërë si një lloj tradite në Drejtorinë e Urbanizmit edhe më herët. Njerëzit ndërrohen, por mënyra e trajtimit të kërkesave dhe ankesave shpesh mbetet e njëjtë. Shpesh nuk merret përgjigje për kërkesat apo ankesat. Kjo është një vërejtje nga ana ime dhe shpresoj që në të ardhmen të përmirësohet.

z.Korab Krasniqi: Që nga dita kur kam marrë detyrën, nuk besoj se ka ndodhur që dikush të mos marrë përgjigje për kërkesën e tij. Gjithashtu nuk besoj se ju keni bërë ndonjë kërkesë konkrete dhe nuk keni marrë përgjigje. Për këtë arsye mendoj se nuk është e drejtë të krijohet një përshtypje e tillë për këtë periudhë.

z.Agim Mjaku: Pjesën më të madhe të jetës e kam kaluar në këtë qytet dhe e di shumë mirë si frymëzon ky qytet. A duhet të ketë kalldrëm qyteti? Po, duhet të ketë. Mirëpo çfarë kalldrëmi duhet të jetë, këtë duhet ta përcaktojnë Komuna dhe ekspertët. Ajo që më habit është fakti se në këtë takim nuk janë prezent Policia, komandanti apo përfaqësues të gjykatës, sepse qytetin më së shumti e ngarkojnë automjetet. Nga numri i madh i automjeteve nuk mund të shihet as kalldrëmi.
Duhet të përcaktohet qartë kush ka të drejtë të hyjë në qytet dhe me çfarë ngarkese mund të qarkullojnë kamionët apo traktorët. Në zonat ku ka kalldrëm nuk duhet të ketë qarkullim të automjeteve. Nëse duam të kemi një kalldrëm të mirë dhe të qëndrueshëm, duhet edhe punë cilësore dhe rregulla të qarta për qarkullimin.
Unë kam qenë në vitin 2002 në Durrës dhe nga Xhamia deri te porta qyteti ishte i shtruar me kalldrëm me gur të zi të importuar nga Italia. Nuk jam kundër modernizimit, por modernizimi duhet të shoqërohet me mirëmbajtje. Neve shpesh na ka munguar mirëmbajtja, por edhe puna profesionale. Duhet mjeshtër të mirë dhe infrastrukturë përcjellëse cilësore për t'i dhënë qytetit një pamje të bukur që nesër të jetë tërheqëse edhe për vizitorët. Për shembull, pjesa te "Guri i Shpum" ku janë rregulluar shkallët është shumë mirë e realizuar. Pse të mos i japim edhe qytetit një pamje të mirë me kalldrëm cilësor? Besoj se Komuna ka potencial dhe inxhinierë të mirë për ta bërë një projekt të mirë.

z.Harun Elezi: A është analizu mirë kjo pjesa që po mendoni me e shtru me asfalt? Sepse nëse vendoset me u ba asfalt, atëherë sipas mendimit tem duhet me u ba komplet rrethi me asfalt, që me pas një zgjidhje të njëtrajtshme.
Kjo pjesa me kalldrëm, sidomos te ndërtimet e lokaleve, duhet me u mendu mirë. Ajo pjesë e ruan një identitet të veçantë të zonës dhe para se me u marrë vendimi duhet me u analizu mirë çka planifikohet me u zhvillu apo me u hapë aty përpara dhe a përshtatet me karakterin e asaj pjese.
Sa i përket pjesës rreth xhamisë, mendoj që është më e arsyeshme me u shtru me asfalt, sepse mirëmbajtja ka me qenë shumë më e lehtë.
Ndërsa te pjesa ku planifikohet me u vendos kalldrëmi, duhet me u analizu mirë çfarë automjetesh kanë me qarkullu aty dhe a mundet ajo sipërfaqe me e përballu peshën e tyre. Nuk është e logjikshme me u leju automjete me peshë të rëndë me hy në atë pjesë, sepse kalldrëmi dëmtohet shumë shpejt dhe pastaj prapë krijohen shpenzime për riparime.

z.Qendrim Vogliqi: Nuk është një problem aq i madh sa po paraqitet. Në thelb është një punë shumë e thjeshtë. Kalldrëmi në vetvete nuk është problem ajo që ka rëndësi është cilësia e punës. Kompania që e merr projektin duhet të ketë cilësi dhe gjithashtu duhet të ketë mbikëqyrje të mirë nga mbikëqyrësit e komunës, në mënyrë që puna të realizohet ashtu siç është paraparë nga projektuesit.
Unë në këto raste do ta propozoja që të hapet një konkurs për këtë rrugë. Në atë konkurs mund të marrin pjesë kompani projektuese, jo vetëm nga Kosova, por edhe nga rajoni. Nëse nuk mund ta bëjnë kompanitë vendore, atëherë kompani të tjera mund të ofrojnë një zgjidhje më të mirë se të gjitha idetë që po i diskutojmë këtu.
Një ide e mirë mund të ndikojë edhe në zhvillimin e qytetit, sepse mund të tërheqë turistë dhe njëkohësisht përfitim për të gjithë bizneset dhe shitoret që janë përreth.
Ne duhet ta kemi parasysh që historia nuk përfundon dhe zhvillimi nuk duhet të bëhet duke e harruar historinë. Objektet e vjetra që janë ndërtuar nga viti 1945 deri në vitin 1990, të cilat i kemi parë edhe në ekspozita, përfaqësojnë një frymë moderne që ka ardhur nga Evropa. Megjithatë, arkitektët e asaj kohe kanë përdorur edhe materiale rajonale, si për shembull tullën. Nëse i shikoni sot fasadat e disa objekteve, do të shihni se ato kanë ende pjesë me tulla.
Kjo tregon se modernizimi nuk do të thotë të fshihet historia. Përkundrazi, zhvillimi duhet të bëhet duke e respektuar dhe ruajtur historinë.
Për këtë arsye mendoj se zona rreth e rrotull xhamisë është ndër zonat më të vjetra dhe do të ishte mirë të ruhej me kalldrëm, por puna duhet të bëhet me cilësi dhe ashtu siç duhet. Megjithatë, në fund vendimi është në dorën tuaj, sepse ju jeni ata që merrni vendimet përfundimtare.

z.Arian Teneqja: Kjo është në fazën e diskutimeve dhe secili e jep mendimin e vet. Dikush mendon ndryshe, dikush ndryshe, dhe për këtë arsye jemi këtu. Askush nuk mundet me thënë: ti e ke mirë, ti e ke keq.
Sa i përket aspektit historik, nuk kemi nevojë me dëshmu që jemi autokton, sepse jemi autokton. Kanë ndodhë ndryshime arbitrare, varësisht prej historisë. Prej ilirëve kemi mbetje, kemi mbetje edhe prej romakëve, edhe prej osmanëve, sepse janë pjesë e historisë dhe e periudhave të ndryshme.
Por kjo nuk do të thotë që patjetër duhet me i dhënë zor me konservu diçka që nuk është. Ne nuk jemi duke ndikuar në trashëgiminë kulturore.
Pjesa e Çarshisë që ka qenë me kalldrëm do të mbetet e tillë dhe do të vazhdohet deri në fund, duke i dhënë qasje dhe vazhdimësi asaj zone. Por njëkohësisht duhet të kemi parasysh edhe funksionalitetin e përditshëm të qytetit. Rruga pranë Xhamisë është një rrugë lidhëse shumë e ngushtë dhe nuk është shesh apo hapësirë tjetër publike.
Qyteti ka dy rrugë kryesore rrugën Qamil Ilazi dhe rrugën Ismail Raka dhe këto duhet të lidhen mirë mes vete në mënyrë që të mos krijohen pengesa apo tollovi në qarkullim.
Ky projekt nuk është një projekt i madh që kërkon konkurse apo projektues të huaj. Bëhet fjalë për një ridizajnim të një segmenti të rrugës për ta përmirësuar gjendjen ekzistuese.
Sa i përket pjesës para Komunës, Instituti Arkeologjik ka bërë hulumtime dhe nuk është identifikuar ndonjë objekt me vlerë të veçantë që kërkon konservim. Sipas raporteve të tyre bëhet fjalë vetëm për disa mure që nuk kanë vlerë të veçantë historike.
Megjithatë, të gjitha mendimet dhe sugjerimet tuaja do të merren parasysh dhe do të shqyrtohen gjatë përgatitjes së propozimit final të projektit.

z.Agim Mjaku: Dua të shtoj edhe diçka: në qytete të tjera si Shkupi apo Prizreni nuk kam parë që automjetet të qarkullojnë nëpër kalldrëm. Nëse dikush ka parë ndryshe, le të na tregojë.

z.Arian Teneqja: Zakonisht kalldrëmi është ruajtur në sheshe apo në pjesët më të vjetra të qyteteve ku qarkullimi i automjeteve është i kufizuar. Edhe në këtë rast synimi është që të kufizohet qarkullimi i mjeteve në ato zona.

znj.Arijeta Jusufi: Në atë pjesë duhet të kufizohet qarkullimi. Gjatë punimeve sigurisht që do të ketë lëvizje të makinerive, por pas përfundimit të projektit duhet të ketë rregulla të qarta për qarkullimin.

Kryetari i Komunës: Vetëm një sqarim të shkurtër sa i përket mbarëvajtjes së këtyre punimeve. Pajtohem që shpesh ka mangësi, por duhet ta kemi parasysh se çdo kryetar komune dhe çdo institucion penalizohet nga Ligji i Prokurimit Publik. Sipas këtij ligji, kontrata duhet t'i jepet operatorit ekonomik që ofron çmimin më të ulët. Në praktikë kjo shpesh nënkupton që kur çmimi është më i ulët, edhe cilësia mund të jetë më e dobët. Megjithatë, unë zotohem bashkë me ekzekutivin tim që të bëjmë përpjekje maksimale për të rritur cilësinë e projekteve, jo vetëm në këtë rast, por gjatë gjithë mandatit. Rritja e cilësisë së punimeve është një nga prioritetet kryesore të këtij mandati.
Duhet të kemi parasysh edhe faktin se shpesh projektet vonohen për shkak të procedurave të prokurimit dhe ankesave ndërmjet kompanive. Ka pasur raste kur janë dashur dy vite për të lidhur një kontratë për shkak të ankesave. Megjithatë, ne jemi të obliguar të veprojmë gjithmonë në përputhje me Ligjin e Prokurimit.
Sa i përket kalldrëmit, dëshira jonë do të ishte ndoshta që ta zgjerojmë edhe më shumë. Por nëse jeni të gatshëm të presim edhe një vit me gjendjen aktuale dhe me gropat që janë në rrugë, atëherë mund të mendojmë për një projekt më të madh, siç u përmend edhe më herët. Megjithatë, kjo kërkon kohë dhe rritje të buxhetit.
Të gjitha këto që po diskutojmë bazohen në mundësitë buxhetore që kemi aktualisht. Puna e kalldrëmit dhe e ujit në Komunën e Kaçanikut është urgjente dhe për këtë arsye ju kemi ftuar në këtë debat për të dëgjuar mendimet tuaja. Edhe pse ne kemi të drejtën për të marrë vendime, nuk kemi dashur ta bëjmë këtë pa dëgjuar qytetarët. Po të kishim dashur të vendosnim vetë, nuk do të kishte qenë e nevojshme të organizonim këtë debat publik. Ju falënderoj për pjesëmarrjen e madhe, sepse rrallë ndodh që qytetarët të marrin pjesë kaq shumë në dëgjime publike. Për shembull, gjatë dëgjimeve për buxhetin edhe pse organizojmë rreth shtatë takime me qytetarë shpesh marrin pjesë vetëm tre apo katër persona. Megjithatë, pasi buxheti miratohet, ne kemi obligim ta zbatojmë atë.

z.Qendrim Vogliqi: Kryetar, unë pres që pasi t'i merrni sugjerimet tona, t'i analizoni dhe ndoshta t'ia përcillni edhe kompanisë projektuese. Ata mund ta rishikojnë projektin dhe të dalin me një propozim tjetër, ndoshta më të mirë se ky aktual. Do të ishte mirë që pastaj të organizohej edhe një debat tjetër publik. Më vjen mirë që sot ka kaq shumë qytetarë të pranishëm, sepse në takime të tjera ka ndodhur që të jenë vetëm dy apo tre persona.
Në atë fazë mund të shqyrtohen më mirë të gjitha elementet: vlerat historike, trajtimi i kalldrëmit, qarkullimi i automjeteve, hapësirat publike, trotuaret dhe infrastruktura nëntokësore. Gjithashtu mund të merren si shembull praktikat e vendeve tona dhe të rajonit.

znj.Ardita Rrahmani: Deshta me u ndërlidh me parafolësin. Ai po kërkon prej kompanisë projektuese me pru një ide tjetër, por ne po flasim për një rrugë. Kompania mundet me ardhë me ide, ama nuk mundet me ta ndërru rrugën. Gjithashtu po kërkon edhe një debat publik. Parimisht jam që të gjitha vendimet me u marrë paraprakisht duke diskutuar me qytetarë. Mirëpo ne e kemi një rrugë, e jo dy, që me pas dy alternativa.
Ti po i qet opsionet dhe idetë përpara, por ne po flasim për një rrugë, ndërsa ti po kërkon me e shterë debatin me dy apo tri faza. Ndoshta për ty edhe faza e dytë apo e tretë mund të jenë të pamjaftueshme.
Unë vetëm nuk e pata të qartë prej teje dhe, nëse kishe mujt me u përgjigj, jam e bindur që edhe qytetarët këtu duan me ditë: çka konkretisht po kërkon?
A je duke dashtë me bë rreth e rrotull me kalldrëm për me e ruajt identitetin e Komunës së Kaçanikut dhe të Çarshisë së Vjetër? Apo je duke dashtë gjysmë asfalt e gjysmë kalldrëm?
Tri herë je duke folur për këtë çështje dhe sinqerisht nuk po të kuptoj.

z.Qendrim Vogliqi: Thash që unaza rreth xhamisë është pjesa më e vjetër dhe duhet të ruhet me kalldrëm, siç është ruajtur edhe më herët. Pjesa tjetër nuk duhet të shkojë deri në fund, por deri te busti i Idriz Seferit, sepse kjo është zona më e vjetër dhe ka rëndësi historike. Mendimi im profesional është që kjo të trajtohet me qetësi dhe vizion të qartë, duke u bazuar në praktikën e vendit tonë dhe të rajonit. Për shembull, mund të shikojmë Gjirokastrën, Bosnjën, ose Prizrenin, se si kanë ruajtur kalldrëmin dhe e kanë trajtuar zonën historike.
Sa i përket debateve publike, Komuna është institucion i përhershëm, ndërsa njerëzit dhe drejtorët ndërrohen. Nëse nuk do të kishin dalë në pah disa probleme më herët, si për shembull te projekti i parkingut nëntokësor, mund të ishte ndërtuar një objekt jo funksional me një investim prej 200–300 mijë eurosh. Unë kam dërguar email me këto sugjerime dhe qëndroj prapa tyre edhe sot, siç e kanë bërë edhe shumë të tjerë. Jam pro ruajtjes së zonës historike dhe zhvillimit të saj në mënyrë të kontrolluar. Për këtë arsye, duhet të involvohen inxhinierët e infrastrukturës që të gjejnë zgjidhjet për komunikacionin dhe parkingjet, në mënyrë që të mos mbetet vetëm një ide për diskutim, por një projekt i realizueshëm dhe funksional.
Institucionet e sigurisë duhet të marrin masat e nevojshme, dhe për këtë arsye kërkoj edhe debat publik për të gjitha këto çështje.

znj.Nazife Krasniqi: Unë jetoj në atë zonë dhe është e vërtetë që ajo është ndër zonat më të vjetra të Kaçanikut. Ne do të dëshironim ta ruanim identitetin e qytetit, sepse nuk kemi shumë vende historike për vizitorët. Para disa muajsh takova disa vizitorë nga Shqipëria dhe më pyetën çfarë mund të vizitonin në qytet. Ata u interesuan për historinë dhe për vendet e ruajtura historike.
Edhe unë do të preferoja kalldrëmin për të ruajtur identitetin, por e kuptoj edhe atë që tha kryetari për mundësitë dhe kapacitetet financiare. Ne si banorë duam një zgjidhje, sepse jetojmë çdo ditë me këtë problem. Qarkullimi është i domosdoshëm dhe edhe automjetet tona po dëmtohen nga gjendja e rrugës. Prandaj po mundohemi të gjejmë një zgjidhje që njëkohësisht e ruan identitetin dhe e përmirëson funksionalitetin.

z.Ylber Tusha: Edhe unë pajtohem me atë që tha parafolësja gjithçka që theksoi për rëndësinë e ruajtjes së identitetit të qytetit dhe nevojën për një rrugë funksionale është e saktë.

z.Korab Krasniqi: Në këtë debat jemi përpjekur të përfshijmë kryesisht banorët e zonës që përballen çdo ditë me këtë rrugë. Mund të kishim sjellë edhe persona të tjerë, por kemi dashur të marrim mendimin real të atyre që e përdorin çdo ditë këtë rrugë.
Pjesa që është propozuar të bëhet me asfalt është menduar edhe për të ardhmen, në rast se realizohet nje ndërtim në rrugën "Mejdi Dalloshi". Në atë rast mjetet e rënda do të mund të qarkullojnë nëpër segmentin me asfalt dhe jo nëpër pjesën me kalldrëm. Për këtë arsye është paraparë që kjo unazë të jetë me asfalt. Pjesën që kemi mundur ta ruajmë me kalldrëm e kemi ruajtur dhe e kemi trajtuar me kujdes.
Prandaj kërkoj nga të gjithë mirëkuptim që të reflektojmë dhe të ecim përpara me projektin. Nëse duam të ruajmë të gjitha vlerat në mënyrën më të plotë të mundshme, atëherë ndoshta duhet të presim deri sa të krijohen kushtet financiare për një projekt më të madh. Për momentin një rikonstruktim më i lehtë i rrugës mund të jetë alternativa më e realizueshme.

z.Osman Gashi: Unë jam dakord që rrethi të bëhet me asfalt, ndërsa pjesa tjetër, për shembull te rruga Idriz Seferi, të trajtohet me kubeza.

z.Gent Haxhiu: Mendoj se projekti është i mirë, vetëm se rikonstruktimi i kalldrëmit duhet të bëhet me cilësi më të lartë.

z.Korab Krasniqi: Ju falënderoj shumë të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj. Gjithsesi do të informoheni me kohë për zhvillimet e mëtejshme lidhur me ridizajnimin e kësaj rruge.

Procesmbajtëse
Mavije Murseli

Drejtori i DUKMM
Korab Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

Kaçanik,05/03/2026